



Datë: 15.04.2025

Numër protokolli: 2499/2025

A.nr.350/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Malsore Gashi Bajraktari-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.350/2025 të datës 21.02.2025 të parashtruar nga ankuesja L.R, të cilën me autorizim e përfaqëson Avokat Faton Fetahu, nga Prishtina, kundër Vendimit Nr.I.115/02-KOM të datës 13.02.2025 të Komisioni Disiplinor të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, në çështjen juridike “*Ndërprerje e Marrëdhënies së punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 15.04.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Anulohet Vendimi Nr.I.50/02-KOM i datës 23.01.2025 i U.D/Sekretares së Përgjithshme, Vendimi Nr.I.27/02-KOM i datës 14.01.2025 dhe Vendimi Nr.I.115/02-KOM të datës 13.02.2025 i Komisionit Disiplinor i Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, ndërsa lënda kthehet ***në rishqyrtim*** dhe ***rivendosje*** te Komisioni Disiplinor.

II. Obligohet Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, që të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme ligjore për zbatimin e këtij vendimi në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij, duke e rishqyrtuar dhe rivendosur lëndën e ankuesit sipas kërkesës për iniciimin e procedurës disiplinore të datës 03.12.2024.

III. Obligohet U.D/Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë që të kujdeset për bëjë zbatimin e këtij vendimi të përcaktuar si në pikën **II të dispozitivit**, brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Nëpunësja civile, L.R (tani e tutje referuar vetëm Ankuesja), më datë 21.02.2025 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është regjistruar me numër protokolli 1176/2025, kundër Vendimit Nr.I.115/02-KOM të datës 13.02.2025 të Komisioni Disiplinor të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, përmes të cilit ankuesit i është shqiptuar masa disiplinore “*Largim nga Shërbimi Civil*”.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 03.03.2025 ka kërkuar përgjigje në ankesën e ankueses nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, ndërsa kjo e fundit më datë 05.03.2025 ka përcjellë përgjigjen në ankesë bashkë me shkresat e bashkëngjitura të lëndës, Ndërsa Kryetari i Këshillit përmes vendimit VK/2025 të datës 26.03.2025 i ka shtyrë afatin e vendimmarrjes edhe për 10 ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritorë administroi këto prova: Ankesën e datës 18.02.2025 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimin e datës 03.01.2025; Kopjen e letërnjoftimit të ankueses; Vendimin e datës 13.02.2025 të Komisionit Disiplinor; Plotësimin e kërkesës për iniciimin e procedurës disiplinore e datës 10.01.2025; Ankesë e datës 11.11.2024; E-mailin e datës 08.01.2024 dërguar nga I.K për E.K me korrespondencën e bashkangjitur; Vendimin e datës 18.11.2024 të UD/Kryeinspektore në Inspektoratin Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut; Vendimin e datës 28.10.2024 të Inspektorit të Tregut me aktvendimin e datës 28.10.2024; Pëlqimin e datës 01.11.2024; Kërkesën e datës 20.09.2024; Çertifikatë e regjistrimit e datës 18.07.2024; Procesverbal i datës 23.10.2024; Procesverbal i datës 04.10.2024; Kërkesë e datës 30.09.2024; Përgjigje e datës 10.09.2024; Vendimin e datës 14.01.2025 të Komisionit Disiplinor; Kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore të datës 03.12.2024; Ankesën e datës 18.11.2024 me shifër:5934/19; E-mailin e datës 02.12.2024 dërguar nga ankuesja për E.K; Formular i regjistrimit të ankesës i datës 21.02.2025; Kërkesë për përgjigje e datës 03.03.2025; Përgjigje në kërkesë e datës 05.03.2025; Ndryshimi dhe plotësimi i akt emërimit të ankueses i datës 11.04.2019; Formularët e vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2022; E-mail i datës 09.01.2025 dërguar nga V.R-V për B.F.M dhe të tjerët; Vendimin e datës 12.11.2024 të U.D Sekretares së Përgjithshme të MINT; Vendimin e datës 16.01.2025 të U.D Sekretares së Përgjithshme të MINT; Vendimin e datës 12.12.2024 të U.D Sekretares së Përgjithshme të MINT; Vendimin e datës 09.12.2024 të U.D Sekretares së Përgjithshme të MINT; Akt Emërimit e datës 26.02.2024; Akt Emërimit e datës 31.01.2012; Vendimin e datës 23.05.2024 të U.D Sekretares së Përgjithshme të MINT; Ndryshimin dhe plotësimin e akt emërimit të datës 07.10.2014; Vendimi i datës 23.01.2025 i .D Sekretares së Përgjithshme të MINT; Vendimin e datës 16.01.2025 të Komisionit Disiplinor; vendimi VK/2025 të datës 26.03.2025.

Kolegji i Këshillit pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e bashkangjitura të lëndës, konstatoi se ka bazë të mjaftueshme që lënda e ankueses të kthehet në *ri-shqyrtim* dhe *rivendosje*, sepse:

Nga administrimi i provave të lëndës, Kolegji i Këshillit, ka konstatuar se ankuesja sipas Ndryshimit dhe Plotësimit të Aktit të Emërimit të datës 11.04.2019 është e punësuar në pozitën *Zyrtar Ligjor* në Inspektoratin e Tregut në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë. Tutje Ushtruesja e Detyrës së Kryeinspektore në Inspektoratin e Tregut, më datë 03.12.2024 përmes shkresës me shifër:1-1323/19 i është drejtuar Komisionit Disiplinor me kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore me supozimin se ankuesja ka kryer shkelje të rënda të përcaktuara me nenin 56, paragrafi 4, nën paragrafi 4.5, 4.6, 4.7, 4.8, 4.9, 4.13 dhe 4.14 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe me nenin 5, paragrafi 6, 8 dhe 9, nenin 9 paragrafi 1, nën paragrafi 1.3 dhe 1.9 të Ligjit Nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, me arsyetimin se ankuesja e kishte hartuar ankesën në emër të operatorit ekonomik, fakt ky i dëshmuar në emailin e datës 02.12.2024 të cilin e kishte përcjellë tek U.D Kryeinspektorja në Inspektoratin e Tregut. Po ashtu, ko e fundit me datë 10.01.2025 ka bërë plotësimin e kërkesës për iniciimin e procedurës disiplinore, me supozimin se përveç shkeljeve nga neni 56 paragrafi 4 i Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, ankuesja me veprimet e saj ka rënë ndesh edhe me nenin 5, paragrafi 6, 8 dhe 9, nenin 9 paragrafi 1, nën paragrafi 1.3 dhe 1.9 të Ligjit Nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik të specifikuara edhe në kërkesën për iniciimin të datës 03.12.2024, me arsyetimin se ekziston dyshimi i bazuar se edhe tek një rast tjetër për një operator tjetër, ankuesja e ka hartuar ankesën e datës 11.11.2024, dyshim ky që mbështetej në analizimin e dy ankesave duke iu referuar rezolucionit dhe fondit të shkronjave, si dhe nënshkrimi në ankesën e datës 11.11.2024 nuk ishte i pronarit/ankuesit, dhe përveç ankesës dyshohet se e njëjta ka hartuar për operatorin e njëjtë edhe kërkesën e datës 30.09.2024, dhe po ashtu e njëjta dyshohet se ka hartuar edhe kërkesën e datës 06.09.2024 për një operator tjetër ekonomik.

Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, duke vepruar sipas kërkesës së datës 03.12.2024 për iniciimin e procedurës disiplinore si dhe shkresës së datës 10.01.2025 për plotësimin e kërkesës fillestare, ka zhvilluar procedurën disiplinore dhe me datë 14.01.2024 ka nxjerrë Vendimin me shifër:1-27/02-KOM përmes të cilit akt, ankueses i ka shqiptuar masën disiplinore ***“Pezullim nga pozita pa pagesë gjashtë muaj”*** për shkak të shkeljeve të rënda disiplinore të përcaktuara me nenin 56, paragrafi 4, nën paragrafi 4.5, 4.6, 4.7, 4.8, 4.9, 4.13 dhe 4.14 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, si dhe me nenin 5, paragrafi 6, 8 dhe 9, nenin 9 paragrafi 1, nën paragrafi 1.3 dhe 1.9 të Ligjit Nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, me arsyetimin se ankuesja e kishte hartuar ankesën në emër të operatorit ekonomik, fakt ky i dëshmuar në e-mailin e datës 02.12.2024 të cilin e kishte përcjellë tek U.D Kryeinspektorja në Inspektoratin e Tregut.

Tutje, nga shkresat e lëndës Kolegji i Këshillit po ashtu konstatoi se, se pas nxjerrjes së Vendimit të datës 14.01.2025 nga ana Komisionit Disiplinor, fillimisht U.D/Sekretarja e Përgjithshme në MINT, me datë 16.01.2025 përmes Vendimit me shifër Ref:02/Nr.03 e ka bërë Ndryshimin dhe Plotësimin e Vendimit me numër protokolli: 1-1409/02 të datës 12.12.2024 për Formimin e Komisionit Disiplinor , ashtu që anëtari

B.B është zëvendësuar nga anëtari F.L, kurse Komisioni Disiplinor sipas përbërjes së re, në po të njëjtën datë me 16.01.2025 nxjerrë Vendimin me shifër:1-33/02-KOM përmes të cilit akt ia ka vazhduar afatin e vendimmarrjes procedurës së iniciuar disiplinore, ndërsa më pastaj me datë 21.01.2025 U.D/Sekretarja e Përgjithshme në MINT përmes vendimit me shifër:1-50/02 e anulon Vendimin e Komisionit Disiplinor të datës 14.01.2025 përmes të cilit ankueses i ishte shqiptuar masa disiplinore **“Pezullim nga pozita pa pagesë gjashtë muaj”**, me arsyetimin se vendimi i Komisionit Disiplinor nuk ka qenë i drejtë pasi që ankuesja ka kryer vepra të kundërligjshme dhe jo të lejueshme për shërbyesit civil, duke shtuar faktin se anëtarët e Komisionit Disiplinor (L.G dhe N.Sh) dyshojnë se veprimi i tyre nuk ka qenë i drejtë pasi që nuk janë jurist me profesion, kurse U.D/Sekretarja e Përgjithshme në MINT, vendimmarrjen e saj e mbështet në dispozita e nenit 53 të LPPA-së.

Më pas, Komisioni Disiplinor ka vazhduar me procedurën disiplinore, ashtu që me datë 13.02.2025 ka nxjerrë Vendimin me shifër:I-115/02-KOM përmes të cilit ankueses i ka shqiptuar masën e rëndë disiplinore **“Largim nga shërbimi civil”** me arsyetimin se ankuesja ka kryer shkelje të rënda të përcaktuara me nenin 56, paragrafi 4, nën paragrafi 4.5, 4.6, 4.7, 4.8, 4.9, 4.13 dhe 4.14 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, dhe me nenin 5, paragrafi 6, 8 dhe 9, nenin 9 paragrafi 1, nën paragrafi 1.3 dhe 1.9 të Ligjit Nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, pasi që ankuesja e kishte hartuar ankesën në emër të operatorit ekonomik, fakt ky i dëshmuar në e-mailin e datës 02.12.2024 të cilin e kishte përcjellë tek U.D Kryeinspektorja në Inspektoratin e Tregut, të përcaktuara si në kërkesën e datës 03.12.2024 për iniciimin e procedurës disiplinore, ndërsa lidhur me supozimet e ngritura në plotësimin e kërkesës për iniciimin e procedurës disiplinore me datë 10.01.2025, Komisioni Disiplinor ka konstatuar se çështjet e tilla përmbajnë elemente të veprës penale dhe se nuk ka kompetencë t’i shqyrtoi.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshill kundër aktit të kontestuar, pretendon se Komisioni Disiplinor me rastin e zhvillimit të procedurës disiplinore dhe shqiptimit të masës disiplinore ka kryer shkelje esenciale të dispozitave të procedurës administrative, zbatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatim të gabuar të ligjit materiale, me arsyetimin se akti i kontestuar nuk përmban detyrimet ligjore të përcaktuara me nenin 4, paragrafi 1, nenin 5 dhe 48 të LPPA-së si dhe ka vendosur për çështje të cilat nuk ka kompetencë lëndore sipas Ligjit Nr.06/L-011 për parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, ka vendosur jashtë afatit të përcaktuar me nenin 13 paragrafi 7 të Rregullores Nr.01/2024 Për Disiplinën e Nëpunësve Civil, si dhe me në kundërshtim me dispozitat e ligjit material, Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik në kuptim të konstatimit të gjendjes faktike dhe klasifikimit të shkeljes së supozuar.

Kolegji i Këshillit, nga konstatimet e dhëna si më lartë, fillimisht para se të lëshohet në shqyrtimin meritore lidhur me masën e shqiptuar disiplinore nga ana e Komisionit Disiplinor ndaj ankueses, duke marrë dispozitat e aplikuara të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe dispozitat e ligjit material që rregullojnë çështjet procedurale dhe kompetencën e organeve përkatëse, vendosi që të analizoi procedurën e zhvilluar disiplinore nëse në faza të ndryshme ka pasur shkelje procedurale, dhe konstatoi si në vijim.

Komisioni Disiplinor fillimisht ishte themeluar me datë 13.11.2024 nga U.D/Sekretarja e Përgjithshme në MINT përmes Vendimit më shifër: I-1192/02 në përbërje prej E.K-kryesuese, Sh.K-anëtare dhe N.Sh-anëtare, ndërsa me datë 09.12.2024 përmes Vendimit më shifër: I-1352/02 bëhet plotësim ndryshimi i Vendimit të datës 13.11.2024, ashtu që kryetarja e Komisionit Disiplinor, E.K zëvendësohet me anëtarin L.K, me arsyetimin se kjo e fundit është edhe iniciuese e procedurës disiplinore dhe qëndrimi në komisionin disiplinor paraqet konflikt interesi, ndërsa me datë 12.12.2024 përmes Vendimit më shifër: I-1409/02 bëhet plotësim ndryshimi i Vendimit të datës 09.12.2024, ashtu që anëtari L.K, zëvendësohet me anëtarin B.M, kurse përmes Vendimit të datës 16.01.2025 me shifër: I-32/02 bëhet plotësim ndryshimi i Vendimit të datës 12.12.2024 ashtu që anëtari B.M, zëvendësohet me anëtarin F.L.

Thënë si më lartë, nga konstatimet e dhëna si në arsyetimin e këtij vendimi, duke u bazuar në shkresat e lëndës të ofruara në cilësi të provave materiale nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të MINT përmes shkresës së datës 04.03.2025, Kolegji i Këshillit konstatoi se sipas vendimmarrjes së U.D/Sekretarja e Përgjithshme në MINT lidhur me themelimin e Komisionit Disiplinor dhe plotësim ndryshimit të tij, Kolegji i Këshillit konstatoi se deri me datë 15.01.2025 Komisioni Disiplinor ka pasur këtë përbërje: B.M-kryesues, Sh.K dhe N.Sh-anëtare, ndërsa Vendimin fillestar të Komisionit Disiplinor të datës 14.01.2025, e kanë nënshkruar B.M në cilësi të kryesuesit, kurse në cilësi të anëtarëve e kanë nënshkruar L.G dhe N.Sh, mirëpo ajo që mbetet kontestuese në këtë mes është se MINT nuk e ka mbështetur më asnjë provë se zyrtarja L.G të jetë caktuar anëtare e komisionit disiplinor.

Tutje, Kolegji i Këshillit, po ashtu konstatoi se sipas vendimmarrjes së U.D/Sekretarja e Përgjithshme në MINT lidhur me themelimin e Komisionit Disiplinor dhe plotësim ndryshimit të tij, nga data 16.01.2025 Komisioni Disiplinor ka pasur këtë përbërje: F.L në cilësi të kryesuesit, ndërsa Sh.K dhe N.Sh në cilësi të anëtares, ndërsa Vendimin e Komisionit Disiplinor të datës 13.02.2025 e kanë nënshkruar F.L në cilësi të kryesuesit, kurse në cilësi të anëtarëve e kanë nënshkruar L.G dhe N.Sh, mirëpo ajo që mbetet kontestuese në këtë mes është se MINT nuk e ka mbështetur më asnjë provë se zyrtarja L.G të jetë caktuar anëtare komisionit disiplinor.

Lidhur me Vendimin e datës 14.01.2025 të Komisionit Disiplinor të MINT, Kolegji i Këshillit konstatoi se është akt administrativ i paligjshëm, sikurse përcaktohet me dispozitat e nenit 52 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, 1.2 dhe 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: “52. Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.1. është nxjerre në mungesë të autorizimit nga një ligj, sipas paragrafit 2 të nenit 4 të këtij Ligji; 1.2. organi publik që e nxjerr ka vepruar pa pasur kompetencë; 1.3. është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative”, ngase Komisioni Disiplinor nuk ka as autorizime ligjore dhe as kompetencë të trajtojë shkeljen ose jo të dispozitave të Ligjit Nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, sikurse kishte konstatuar se ankuesja ka shkelur nene të caktuara nga ky ligj, ngase sipas të njëjtit ligj janë përcaktuar qartë kompetencat dhe autorizimet ligjore, ashtu që lidhur me shkeljen e trajtuar nga ky ligj, ka mandat ta bëjë Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, ndërsa në rrethanat e rastit konkret lidhur me shkeljet supozuara që bien në fushën e zbatimit të Ligjit Nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, Komisioni Disiplinor ka mundur t’i drejtohet organit kompetent, sikurse njëra nga zyrtaret (L.G) e cila e ka nënshkruar vendimin e komisionit disiplinor

të datës 14.01.2024, sipas shkresave të lëndës të ofruara nga MINT, nuk figuron se e njëjta të jetë caktuar pjesë përbërë e komisionit përkatës, sikurse përcaktohet me dispozitat e nenit 60 paragrafi 1 dhe 3 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik.

Kolegji i Këshillit duke marr përbazë dispozitat e nenit 52 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, 1.2 dhe 1.5 dhe 1.6 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: “52. *Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.1. është nxjerre në mungesë të autorizimit nga një ligj, sipas paragrafit 2 të nenit 4 të këtij Ligji; 1.2. organi publik që e nxjerr ka vepruar pa pasur kompetencë; 1.5. është në kundërshtim me ligjin material; 1.6. është rezultat i diskrecionit që është ushtruar në mënyrë jo të ligjshme*”, konstatoi se Vendimi i datës 21.01.2025 i U.D/Sekretares së Përgjithshme në MINT është akt i paligjshëm, pasi që e njëjta ka zbatuar gabimisht dispozitat e nenit 53 të LPPA-së, ngase ligji material, respektivisht Ligji Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik nuk ia ka njohur këto autorizime ZKA-ve, gjegjësisht ZKA ka mandat dhe autorizime ligjore vetëm sa i përket themelimit të Komisionit Disiplinor, respektivisht plotësimin ndryshimit të komisionit përkatës vetëm sipas kushteve dhe rrethanave të kuadrit ligjor në fuqi, por në asnjë mënyrë ZKA nuk ka mandat dhe as autorizime ligjore që të anuloi apo shfuqizoi vendimet e Komisioneve Disiplinore, ngase këtë autorizim apo kompetencë ligjore, gjegjësisht kontrollin e ligjshmërisë së akteve të Komisionit Disiplinor të nxjerra ndaj nëpunësve civil e ka vetëm Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës sikurse përcaktohet me dispozitat e nenit 15 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe ligjit për Këshillin, dhe atë Këshilli e ushtron në dy mënyra, nëpërmjet funksionit të shqyrtimit të ankesave në procedurë të rregullt ankimore dhe funksionit të monitorimit të rregullt apo jashtëzakonshëm të institucioneve të administratës publike ku kanë të punësuar nëpunës të Shërbimit Civil, përjashtimisht Komisionet Disiplinore në kuptim të nenit 53 të LPPA-së, munden që ta anulojnë apo shfuqizojnë një akt administrativ të cilën e kanë nxjerrë vetë, por në asnjë mënyrë vendimet e tyre të shfuqizohen apo anulohen nga ZKA.

Po ashtu, lidhur me Vendimin e datës 13.02.2025 të Komisionit Disiplinor të MINT, Kolegji i Këshillit konstatoi se është akt administrativ i paligjshëm, sikurse përcaktohet me dispozitat e nenit 52 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, 1.2 dhe 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: “52. *Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.1. është nxjerre në mungesë të autorizimit nga një ligj, sipas paragrafit 2 të nenit 4 të këtij Ligji; 1.2. organi publik që e nxjerr ka vepruar pa pasur kompetencë; 1.3. është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative*”, ngase Komisioni Disiplinor nuk ka as autorizime ligjore dhe as kompetencë të trajtojë shkeljen ose jo të dispozitave të Ligjit Nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, sikurse kishte konstatuar se ankuesja ka shkelur nene të caktuara nga ky ligj, ngase sipas të njëjtit ligj janë përcaktuar qartë kompetencat dhe autorizimet ligjore, ashtu që lidhur me shkeljen e trajtuar nga ky ligj, ka mandat ta bëjë Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, ndërsa në rrethanat e rastit konkret lidhur me shkeljet supozuara që bien në fushën e zbatimit të Ligjit Nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, Komisioni Disiplinor ka mundur t’i drejtohet organit kompetentë, sikurse njëra nga zyrtaret (L.G) e cila e ka nënshkruar vendimin e komisionit disiplinor të datës 13.02.2024, sipas shkresave të lëndës të ofruara nga MINT, nuk figuron se e njëjta të jetë caktuar pjesë përbërëse e komisionit përkatës, sikurse përcaktohet me dispozitat e nenit 60 paragrafi 1 dhe 3 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik.

Prandaj, nga se u tha si më lartë Kolegji i Këshillit vlerësoi se për shkak të shkeljeve procedurale nga ana e Komisionit Disiplinor, respektivisht për shkak se Komisioni Disiplinor me rastin e nxjerrjes së Vendimit të datës 14.01.2025 dhe atë të datës 13.02.2025 kanë shkelur dispozitat e LPPA-së dhe ligjit material në kuptim të kompetencës dhe autorizimeve ligjore ndërlidhur me zbatimin e Ligjit Nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, sikurse edhe U.D/ Sekretarja e Përgjithshme e MINT, me rastin e nxjerrjes së Vendimit të datës 23.01.2025 përmes të cilit akt e kishte anuluar Vendimin e datës 14.01.2025 të Komisionit Disiplinor, ka vepruara në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik sikurse u konstatua edhe më lartë në arsyetimin e këtij vendimi, andaj Kolegji i Këshilli konstatoi se Vendimi i Komisionit Disiplinor i datës 14.01.2025, Vendimi i U.D/ Sekretares së Përgjithshme e MINT i datës 23.01.2025 si dhe Vendimi i Komisionit Disiplinor i datës 13.02.2025, janë akte administrative të paligjshme sikurse përcaktohet me dispozitat e nenit 52 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, 1.2, 1.3, 1.5 dhe 1.6 të LPPA-së, ndërsa me qëllim të eliminimit të shkeljeve procedurale dhe kthimit të ligjshmërisë, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitivin e këtij vendimi duke anuluar aktet e cekura si më lartë, ndërsa lënda e ankueses është kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje tek Komisioni Disiplinor, kurse për shkak të paligjshmërive dhe shkeljeve procedurale, Këshilli nuk ka mundur të lëshohet në shqyrtim meritore nëse ankuesja ka kryer shkelje të rënda disiplinore ose jo.

Kolegji i Këshillit, thekson faktin se Komisioni Disiplinor me rastin e rishqyrtimit të lëndës së ankueses lidhur me iniciimin e procedurës disiplinore, duhet ta ketë parasysh faktin se duhet të marrë përbazë dispozitat e aplikuara nga ligji material, respektivisht dispozitat e nenit 55 lidhur me përgjegjësinë disiplinore dhe nenin 61 lidhur me parimin e individualizimit të masave disiplinore nga Ligji Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, dhe në secilin rast duhet të zbatojnë drejtë dispozitat e aplikuara nga neni 13, 14 dhe 15 të Rregullores Nr.01/2024 Për Disiplinën e Nëpunësve Civil, ndërlidhur me dispozitat e aplikuara ligjore të përcaktuara si në nenin 2, paragrafi 1, në paragrafi 1.1 të Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kurse U.D/Sekretarja e Përgjithshme e MINT, duhet ta ketë parasysh faktin që në secilin rast Komisioni Disiplinor duhet të jetë i themeluar në pajtim me dispozitat e nenit 60 paragrafi 1 dhe 3 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe Rregulloren Nr.01/2024 Për Disiplinën e Nëpunësve Civil, sikurse që anëtarë të komisionit përkatës nuk mund të jetë asnjë nëpunës civil, nëse paraprakisht nga ZKA nuk është përfshirë në atë komision, si dhe organi punëdhënës kur themelon një komision, apo zyrtari në rastet kur është pjesë e një komisioni me kompetencë të vendimmarrjes duhet të ketë parasysh dispozitat nga nenin 29 i LPPA-së, ndërsa plotësimi dhe ndryshimi i Komisionit Disiplinor duhet të jetë i arsyetuar me shkrim sikurse përcaktohet me dispozitat e kuadrit ligjor në fuqi.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij Vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.350/2025, datë 15/04/2025.

Flakron GASHI

Procesmbajtës

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankueses, Avokat Faton Fetahu;
- Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (Sekretares së Përgjithshme, Komisionit Disiplinor dhe Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore), si dhe;
- Arkivit të KPMSHCK-së.